



Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar
Kosovski Forum Invalidnosti
Kosovo Disability Forum

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Niveli i Zbatimit të Strategjisë Nacionale për Personat me Aftësi të Kufizuar

*Adresojmë mos zbatueshmërinë e të
drejtave të personave me aftësi të
kufizuar në Kosovë - përmes pasqyrimit
të situatës dhe kërkimit të llogaridhënies*

Forumi Kosovar i Aftësisë së
Kufizuar
Str "Tringë Smajli No. 47
Prishtinë
www.kdf-ks.org
info@kdf-ks.org
+381 38 400 055

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e Shkurtesave	- 4 -
HYRJE	- 5 -
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	- 7 -
METODOLOGJIA	- 8 -
LIMITET E STUDIMIT	- 9 -
PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË STRATEGJISË	- 10 -
SHËRBIMET SHËNDETËSORE	- 11 -
<i>Shërbimet shëndetësore për PAK</i>	- 11 -
<i>Pajisjet ndihmëse dhe asistuese</i>	- 13 -
<i>Vetëdijësimi për shëndetin publik</i>	- 14 -
<i>Ngritja profesionale e personelit mjekesor</i>	- 14 -
SISTEMI I MIRËQENIES SOCIALE DHE PUNËSIMI	- 17 -
<i>Punësimi i PAK</i>	- 17 -
<i>Shërbimet në komunitet</i>	- 19 -
<i>Fushata vetëdijësuese për punësimin e PAK</i>	- 20 -
ARSIMIMI DHE MBËSHETJA PROFESIONALE	- 21 -
<i>Vlerësimi i gjendjes ekzistuese</i>	- 21 -
<i>Bartja e kompetencave për arsimimin e FNV tek komunat</i>	- 22 -
<i>Identifikimi dhe edukimi i hershëm</i>	- 23 -
<i>Zhvillimi i Qendrave Burimore</i>	- 24 -
<i>Integrimi i FNV në shkolla të rregullta</i>	- 25 -
<i>Kuadri profesional për arsimin gjithëpërfshirës</i>	- 26 -
<i>Ngritja e vetëdijes shoqërore mbi arsimin gjithëpërfshirës</i>	- 27 -
<i>Cilësia e mësimdhënies dhe arsimit gjithëpërfshirës</i>	- 28 -
INFRASTRUKTURA LIGJORE DHE TË DREJTAT E PAK	- 30 -
<i>Ligjet eksistuese që prekin fushën e aftësisë së kufizuar</i>	- 30 -
QASJA, INFORMIMI DHE SISTEMI I UNIFIKUAR I TË DHËNAVE	- 34 -
<i>Qasja fizike në objekte publike</i>	- 34 -
<i>Qasja në informata</i>	- 35 -
REKOMANDIME	- 37 -

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (FKAK) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Lista e Shkurtesave

AAP – Agjencia për Aftësim Profesional

DKA - Departamenti Komunal i Arsimit

DUDNJ – Deklarata Universale për të Drejtave e Njeriut

FKAK – Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar

FNV – Fëmijët me nevoja të veçanta

IP – Institucione parashkollore

IPK – Institutit pedagogjik të Kosovës

ISCED – Kualifikimi Standard Ndërkombëtar i Edukimit

ISSH – Instituti i Sigurimeve Shoqërore

KNDPAK – Këshilli Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MSH – Ministria e Shëndetësisë

NVA – Nevoja të Veçanta Arsimore

PAK – Personat me Aftësi të Kufizuar

PIA - Plani Individual i Edukimit

SISH – Sistemi Informativ Shëndetësorë

SMIA – Sistemi Monitorues Informues i Arsimit

SHSKUK – Shërbimi Spitalor Klinik Univerzitar i Kosovës

SZHAPU- Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007-2017

UNICEF – The United Nations Children's Fund

QB – Qendra Burimore

QPS – Qendra për Punë Sociale

ZKM – Zyra e Kryeministrit

ZL/ZKM – Zyra ligjore pranë Zyrës së Kryeministrit

ZQM – Zyra për Qeverisje të Mirë

HYRJE

Dokumentet strategjike të Ministrive të ndryshme janë të shumta në numër dhe vazhdojnë të shkruhen e të miratohen, ndërsa pak nga to gjejnë zbatim në praktikë. Kjo për shkak se ka paqartësi rreth përgjegjësi të ministrive të linjës në zbatimin e aktiviteteve që dalin nga planet e veprimit të këtyre strategjive, por edhe sepse përmbajnë dispozita tejet ambicioze dhe të paarritshme, si dhe nuk bazohen në mundësitë dhe limitet buxhetore të këtyre dikastereve qeveritare.

Institucionet publike draftojnë Strategji të ndryshme, në hartimin e të cilave hyn angazhim i resurseve njerëzore, kohë, por edhe shumë e konsiderueshme e buxhetit për grupin punues. Këto Strategji shpesh mbeten vetëm dokumente në sirtarë të Ministrive përkatëse dhe të njejtit edhe pse janë pjesë e grupeve punuese dhe pranojnë të jenë institucione kyçe për implementim të aktiviteteve, gëcin në implementimin në praktikë.

Një nga këto strategji, është edhe Strategjia Nacionale dhjetë-vjeçare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK) 2013 – 2023, e cila përcjellet me dy Plane të Veprimit: 2013 – 2015 si dhe 2018– 2020, duke lënë kështu dy vite zbrazëtirë në Plan të Veprimit, pra vitin 2016 dhe 2017.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë 15% e popullatës botërore janë persona me aftësi të kufizuara duke marrë parasysh të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar – fizike, intelektuale, auditive, vizuale dhe të kombinuar.¹ Fatkeqësisht, në Kosovë akoma nuk kemi shifra të sakta rreth këtij numri të komunikuar zyrtarisht nga institucionet publike, dhe numri i personave me aftësi të kufizuar bazohet në numrin e përfituesve të skemave sociale dhe penzioneve të aftësisë së kufizuar.² Megjthatë, bazuar në disa të dhëna të përafërta në Kosovë ekzistojnë rreth 150.000 persona me aftësi të kufizuar.

Personat me Aftësi të Kufizuar vlerësohet të jenë një ndër grupet më të marginalizuara në shoqërinë Kosovare duke qenë të diskriminuar në parametra të ndryshëm shoqërorë sikurse shërbimet shëndetësore apo sociale, edukimi, punësimi qasja apo edhe mbrojtja ligjore. Në vitin 2013 është zhvilluar Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (nga këtu referuar si: Strategjia) për një periudhë 10 vjeçare e cila ndër të tjera parasheh edhe krijimin e planeve komunale për aftësinë e kufizuar.

Ky raport është komisionuar nga Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar, si pjesë e projektit “Adresojmë mos zbatueshmërinë e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Kosovë - përmes pasqyrit të situatës dhe kërkimit të llogaridhënies”.

Forumit Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (FKAK) është një organizatë ombrellë dhe mekanizëm gjithëpërfshirës i tetë organizatave të personave me aftësi të kufizuar në Kosovë. FKAK është themeluar me asistencën e zyrës së Unionit Evropian në Kosovë dhe Forumit Evropian të

¹ World Health Organization. Media Centre – Disability and Health. <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs352/en/>

² Databaza e Handikos dhe qeverisë lokale - Qendra për Punë Sociale

Aftësisë së Kufizuar. Forumi në kuadër të tij ka të anëtarësuar gjithsej tetë (8) organizata që veprojnë në fusha të ndryshme për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë:

1. Down Syndrome Kosova;
2. HandiKos;
3. Handikep Kosova;
4. Klubi “Dëshira”;
5. Organizata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar;
6. Shoqata e Autizmit;
7. Shoqata Kosovare e të Shurdhërve;
8. Shoqata e të Verbërve të Kosovës;

Këto organizata veprojnë në mënyrë të pavaruar duke përfaqësuar respektivisht interesat e grupeve të veçanta të personave me aftësi të kufizuar. Ndërsa Forumi është një mekanizëm gjithpërfshirës i të gjitha këtyre organizatave me qëllim të unifikimit të tyre dhe adresimit të çështjeve të cilat prekin sfera të ndryshme të jetës së personave me aftësi të kufizuar në Kosovë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport shqyrton të gjitha aktivitetet e specifikuar në Planet e Veprimit 2013-2015 dhe 2018-2020 të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe vlerëson nivelin e zbatimit të tyre në praktikë. Raporti është i fokusuar në pesë fusha tematike: (1) Shërbimet shëndetëore për PAK; (2) Sistemi i mirëqenies sociale dhe punësimi i PAK; (3) Arsimimi dhe mbështetja profesionale për PAK; (4) Infrastruktura ligjore dhe të drejtat e PAK; dhe (5) Qasja, informimi, komunikimi dhe sistemi i unifikuar i të dhënave për PAK. Kjo strukturë e reflekton organizimin e Strategjisë dhe ndarjen e objektivave strategjike, dhe trajton fushat tematike më me rëndësi për PAK.

Raporti shqyrton çdo aktivitet të paraparë në të dy planet e veprimit dhe vlerëson nivelin e zbatimit të tyre në praktikë duke përshkruar iniciativat e ndërmara (ose mungesën e tyre) nga secili institucion i cili paraqitet si institucioni përgjegjës për implementimin e aktivitetit në fjalë. Pra, është shqyrtuar puna e institucioneve të Kosovës në nivel qendror dhe lokal karshi jetësimit të aktiviteteve të cilat bien nën mandatin e tyre. Raporti bazohet në aktivitetet e monitorimit të organizatave për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të profilizuara në fusha të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Qëllimi i këtij raporti është që të ofrohet vlerësim objektiv për punën e institucioneve publike në Kosovë rreth punës dhe angazhimit të tyre në përmirësimin e kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre të plotë në jetën shoqërore dhe ekonomike. Ky dokument ka për qëllim që të jetë reflektim dhe rikujtim për institucionet që janë të obliguara ta jetësojnë strategjinë, që t'i trajtojnë më me seriozitet objektivat e kësaj strategjie dhe të dedikohen në implementimin e aktiviteteve të parapara rreth tyre. Gjithashtu, ky raport është një udhërrëfyes për shoqërinë civile dhe qytetarët të cilët me ushtrimin e presionit publik mund të kontribuojnë në ngritjen e vetëdijes shoqërore dhe institucionale rreth aftësisë së kufizuar, dhe në nxitjen e nivelit të angazhimit të institucioneve publike në implementimin e dokumenteve strategjike në praktikë.

METODOLOGJIA

Për realizimin e vlerësimit të zbatueshmerisë së Strategjisë janë angazhuar përfaqësues të organizatave jo-qeveritare të fushës së mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar që janë nën ombrellën e Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar.

Monitorues nga këto organizata kanë qenë të angazhuar në hulumtim, monitorim dhe analizim të punës së institucioneve qendrore dhe përmes tyre edhe të institucioneve lokale, për vlerësim të nivelit të zbatueshmerisë së Strategjisë nga miratimi e deri në Maj të vitit aktual. Secila nga këto organizata është përcaktuar për hulumtim rreth punës së njëjës nga fushat e mbuluara nga strategjia, bazuar në fushëveprimtarinë dhe ekspertizën e tyre.

Qasja e hulumtimit ka qenë kualitative dhe ka pasur qëllim primar krahasimin e aktiviteteve të parapara në Planet e Veprimit në kuadër të Strategjisë me aktivitetet e realizuara nga institucionet zbatuese të përcaktuara në planet respektive.

Instrumentet e përdorura në mbledhjen e të dhënave

Hulumtim nga zyra

Fillimisht është bërë hulumtimi nga zyra apo “desk-research” nga ku janë analizuar dokumentet si në vijim: Rregulloret dhe udhëzimet administrative që prekin fushën e aftësisë së kufizuar nga 2013 e deri në Maj të vitit 2018, strategjitë dhe planet e veprimit të Ministrive të linjës që nga 2013 e deri më tash për të identifikuar të gjitha fushat ku përmenden politika që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar, dhe korniza ligjore ekzistuese nga 2013 deri më tash me qëllim të analizimit të dispozitave ligjore që e rregullojnë fushën e aftësisë së kufizuar.

Intervistat e thella

Më tej, janë realizuar intervista të thella me zyrtarë të katër ministrive të linjës nën dikasterin e të cilave bie barra kryesore e përgjegjësisë për jetësimin e kësaj Strategjie, bazuar në mandatin dhe fushëveprimtarinë e tyre, përkatësisht:

<i>Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal</i>	<i>Departamenti Ligjor Departamenti për Monitorim të Komunave</i>
<i>Ministria e Shëndetësisë</i>	<i>Departamenti për zhvillim strategjik për shërbime shëndetësore Zyrtarë për të drejtat e njeriut Departamenti për edukim të vazhdueshëm</i>
<i>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë</i>	<i>Divizioni për Arsimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta</i>
<i>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale</i>	<i>Departamenti i Punësimit Departamenti për Mirëqenie Sociale Departamenti për Pensione Agjensioni i Inspektionit Agjensioni i Punësimit</i>

Kërkesat për takime me Sekretarë dhe zyrtarë të Ministrive përkatëse kanë shkuar direkt nga Forumi, dhe zyrtarët kanë qenë të qasshëm për komunikim, dhe bashkëpunim. Monitoruesëve u është dhënë qasje komunikimi me Sekretarët e Ministrive të linjës, të cilët pastaj i kanë angazhuar zyrtarët e departamenteve përkatëse për intervistat e thella me monitoruesit, sipas natyrës së informatave të kërkuara. Gjithashtu janë realizuar takime me zyrtarë të Zyrës për Qeverisje të Mirë ku janë diskutuar të gjitha fushat tematike të Strategjisë.

Konsultimet

Së fundmi, janë mbajtur konsultime të rregullta me ekspertë të fushës së të drejtave të PAK, dhe falenderim i veçantë për kontributin me informacione dhe këshillime i takon përfaqësuesëve politik dhe menaxherial të Forumit, përfshi edhe bashkëpunëtorët e tjerë relevant.

Shkrimi i raportit

Përpunim i të dhënave është bërë mbi bazën e objektivave të strategjisë, të cilat janë mbledhur dhe raportuar nga monitoruesit, përderisa janë interpretuar dhe validuar nga eksperti i kontraktuar.

LIMITET E STUDIMIT

Ky hulumtim fokusohet kryesisht në punën e institucioneve qendrore në jetësimin e Strategjisë, ndërsa shumë kompetenca tani janë bartur në nivel lokal. Pra ekziston nevoja për hulumtim më të detajuar rreth angazhimit të secilës komunë rreth implementimit të aktiviteteve që dalin nga Strategjia dhe në përgjithësi rreth situatës së PAK që jetojnë në ato komuna (numrit të PAK, punësimit të tyre, nevojave shëndetësore, shërbimeve shëndetësore të ofruara nga qendrat e mjekësisë familjare, qasjes dhe kualitetit të shkollimit, etj.). Mbi të gjitha, nisur nga fakti që vetë aftësia e kufizuar është e gjërë në lloj dhe shkallë, mungesa e një sistemi të unifikuar të mbledhjes së të dhënave për PAK në secilin sektor – shëndetësi, arsim, punësim apo mbrojtje ligjore, e ka vështirësuar punën e monitoruesëve/hulumtuesëve në vlerësim të punës së institucioneve, por edhe të vetë zyrtarëve ministrorë në dhënje të përgjigjeve të kërkuara. Prandaj për të kuptuar thellësisht se sa po punohet në sigurimin e të drejtave të barabarta për PAK, fillimisht kërkohet punë dhe angazhim në mbledhje të të dhënave në terren.


Një nga sfidat me të cilat janë përballuar monitoruesit gjatë punës së vlerësimit të zbatueshmërisë së strategjisë përfshinë vështirësitë në qasje në informata në ueb faqet e Ministrive të cilat janë të pa qasshme për PAK të grupit të të verbërve dhe të shurdhërve. PAK me këto lloje të aftësisë së kufizuar, nuk kanë pasur mundësi t'i shqyrtojnë dokumentet në ueb faqeve të ministrive pa ndihmën e asistentëve dhe interpretëve. Së fundmi, sfidë e tejkaloeshme me mirëkuptim në mes të dy palëve ka qenë edhe mungesa e informatave nga ana e zyrtarëve të intervistuar për çështje të caktuara, por që sipas mundësive janë plotësuar me e-maila pasuese.

Ky raport është një vlerësim i përgjithshëm i angazhimit institucional për të drejtat e PAK në nivel vendi, por pasqyrimi edhe më i saktë i situatës aktuale, kërkon monitorim, vëzhgim dhe analizim të vazhdueshëm të punës së institucioneve individuale në nivel lokal dhe qendror.

PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË STRATEGJISË

Strategjia dhjetë-vjeçare për Mbrojtjen e Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK) 2013 – 2023, përcjellet me dy Plane të Veprimit: 2013 – 2015 si dhe 2018 – 2020, duke lënë kështu dy vite zbrazëtirë në planifikim, pra vitin 2016 dhe 2017. Sipas ZQM-së, megjithatë ministrinë kanë vazhduar të punojnë në këtë drejtim, duke implementuar aktivitete që nuk janë zbatuar në tërësi gjatë viteve 2013-2015. Vlen të ceket se sipas ZQM-së Strategjia ka mbetur pa Plan të Veprimit për këtë periudhë si pasojë e mungesës institucionale.


Strategjia Nacionale përbëhet nga pesë objektiva strategjike, ndërsa planet e veprimit i zbërthejnë këto në nën objektiva të quajtura objektiva specifike dhe pastaj në aktivitete që duhen ndërmarrë për arritjen e tyre. Secili aktivitet e ka treguesin, mjetet me të cilat verifikohet arritshmëria, synimin, afatin kohor, buxhetin dhe listën e institucionit/eve kyq/e për zbatim të tij. Në diagramin e mëposhtëm janë të listuara objektivat strategjike dhe objektivat specifike që derivojnë nga to, dhe përkthehen në aktivitete në të dyja planet e veprimit. Gjithashtu në anën e djathtë, figurojnë institucionet të cilat janë listuar si institucione kyqe për implementim të aktiviteteve të ndryshme brenda objektivave specifike.



SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Sipas organizatës Botërore të Shëndetësisë, PAK kanë qasje të limituar në shërbime shëndetësore dhe si rrjedhojë kanë nevoja të paplotësuara për kujdesin shëndetësor³. Kjo situatë është shumë më e shprehur në vendet në zhvillim, kategori në të cilën hyn edhe Kosova. Në vendin tonë shëndetësia është ndër shërbimet publike që përcillet me shumë sfida për të gjithë shoqërinë, e që shprehen akoma më shumë tek personat që kanë nevoja specifike siç janë PAK. Puls i Publik i Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara (UNDP) për vitin 2016 nxjerr përfundimin se 49.7% e popullatës në Kosovë beson se shëndetësia (spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare) kanë korrupsion të shkallës së lartë që nënkupton se për të marrë shërbime të caktuara, qytetarëve u kërkohen para, dhurata ose ndonjë favor tjetër.⁴ Situata për PAK është akoma më e rënduar për shkak të nevojave të tyre të veçanta në fushën e përkujdesjes shëndetësore dhe për shkak të mungesës së kushteve financiare që janë rrjedhojë e mungesës së punësimit dhe varësisë financiare.

Nga kjo Strategji, Ministria e Shëndetësisë, qendrat mjekësore, spitalet, komunat dhe institucione e tjera të fushës obligohen të jetësojnë një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve që derivojnë nga objektiva e parë strategjike: “Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për PAK” – një objektivë tejet e gjërë në përmbajtje dhe si e tillë e vështirë për vlerësim të arritshmërisë. Kjo objektivë pastaj ndahet në tre objektiva specifike për të dyja Planet e Veprimit (gjithashtu vështirë të vlerësueshme se a janë arritur apo jo në praktikë), duke përfshirë kështu (1) “ngritjen e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore”, (2) “zbulimin e hershëm, identifikimin dhe parandalimin e AK”, dhe (3) “krijimi i shërbimit spinal në QKUK” – paraparë në Planin e Veprimit 2013-2015 dhe “rritja e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për PAK” – paraparë në Planin e Veprimit 2018-2020. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se termi “Parandalim i AK” mund të konsiderohet diskriminues sidomos kur bëhet fjalë për fëmijët me sindromën Down, të cilët mund të identifikohen që nga periudha pre-natale dhe parandalimi i kësaj do të nënkuptonte abortim.



Nga këtu e tutje, do të shtjellohen aktivitetet e ndryshme në kuadër të këtyre objektivave specifike, dhe do të vlerësohet zbatueshmëria e tyre në praktikë.

[Shërbimet shëndetësore për PAK](#)

Fillimisht, në Planin e Veprimit 2013-2015 thuhet se do të bëhet sigurimi i qasjes në gjuhën e shenjave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Sipas zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë momentalisht ky shërbim ofrohet vetëm në bazë të Rregullores së Qeverisë së Republikës së

3 Disability and Health, janar, 2018. World Health Organization

4 Puls i Publik XII, nëntor 2016. UNDP Kosovë.

Kosovës për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në institucionet publike, ku ofrohen interpret sipas nevojës në spitale dhe qendra familjare mjekësore. Deri tani, vetëm një interpret në një qendër të mjekësisë familjare është i angazhuar me orar të plotë në nivel vendi.

Nga ana tjetër, nuk dihet se a ekziston një sistem i unifikuar që tregon numrin e personave që kanë pranuar këto lloj shërbime. Ndërsa sa i përket numrit të shërbimeve që u ofrohen PAK, zyrtarë nga MSH kanë raportuar se nuk ka statistika⁵. Kjo sepse sipas tyre, nuk ka mundësi për t'i identifikuar PAK që marrin shërbime shëndetësore pasi që nuk ka mekanizma të avancuar që bën klasifikimin e rasteve. Kjo sepse, në kartelën shëndetësore nuk figurojnë informata mbi ekzistencën ose jo të aftësisë së kufizuar dhe kjo varet nga deklarimi individual. Identifikimi i aftësisë së kufizuar duhet të bëhet nga mekanizmi profesional identifikues që e evidenton prezencën, llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar. Rrjedhimisht edhe shërbimet shëndetësore që ofrohen për PAK do të përmirësoheshin në bazë të kësaj informate. Ndërsa, sipas SHKSH, në vitin 2017 komuniteti i të shurdhërve ka marrë rreth 10 mijë e 200 shërbime në institucione shëndetësore të cilat janë identifikuar pasi këta të fundit kanë përdorur interpretët e gjuhës së shenjave për ti marrë këto shërbime.

Objekivi tjetër specifik “Rritja e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për PAK” parasheh krijimin dhe funksionalizimin e njësisë spinale në kuadër të QKUK-së. Ndërtimi i objektit të përgjithshëm ku përfshihet njësi, ka filluar të ndërtohet dhe pritet të përfundojë në 2019. Sipas zyrtarëve të ministrisë⁵, për këtë njësi do të ndërtohen dy dhoma me nga dhjetë shtretër.

Lista esenciale e barnave dhe plotësimi i saj për të marrë parasysh nevojat e PAK, zë vend si aktivitet edhe në planin e veprimit 2018-2020. Në këtë drejtim mund të vlerësojmë se ka ndodhur progres për shkak se me vendim të ministrit aktual është themeluar një komision që do të ridefinoj listën esenciale të barnave.

Një sfidë tjetër që ndërlidhet me mangësinë e sektorit të shëndetësisë në mbledhjen e statistikave, është futja e të dhënave për PAK në SISH. Kjo është paraparë të bëhet në 2015, por deri më sot nuk ka progres në këtë drejtim sepse sipas Ministrisë së Shëndetësisë, SISH nuk është funksional. Sipas MSH sfidat në funksionalizim të SISH janë të shumëfishta dhe ndër të përfshijnë:

“Mos planifikimi dhe mos koordinimi i aktiviteteve në nivelin e duhur nga Ministria e Shëndetësisë, vonesat në themelimin e mekanizmave koordinuese dhe monitorues ndër institucional, procedurat e tej zgjatura në procedurat e prokurimit për sigurimin e pjesës harduerike dhe softuerike, mungesat e mirëmbajtjes së sistemit, mungesa e kapaciteteve njerëzore, trajnimet jo efikase dhe të pa mjaftueshme për përdorim të sistemit, ngecjet në sigurimin me kohë të bazës së qendrës së të dhënave, vonesat në sigurimin e regjistrimit civil të qytetarëve dhe një mori aktiviteteve të pa realizuara me kohë.”⁶

⁵ Intervistë me zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë, Departamenti për Zhvillim Strategjik për Shërbime Shëndetësore, Zyrtarë për të Drejtat e Njeriut, dhe Departamenti për Edukim të Vazhdueshëm, Prill, 2018.

⁶ “SISH në kolaps, aventura vazhdon”. KOHA.net, 01 prill 2018

Situatë e njejtë rreth SISH vazhdon edhe në 2018. Ndër të tjerash, zyra Kombëtare e Auditimit ka konstatuar se “Programi SISH nuk është duke u shfrytëzuar në nivelin e duhur nga personeli mjekësor, ka konstatuar auditori. Menaxhmenti i institucioneve shëndetësore nuk e ka mbajtur të përgjegjshëm personelin shëndetësor për shfrytëzimin e SISH-it. Personeli shëndetësor i trajnuar nuk ka njohuri bazike lidhur me përdorimin e sistemit.”⁷

Pajisjet ndihmëse dhe asistuese

Gjithashtu në këtë Plan Veprimi thuhet se në listën esenciale të barnave do të përfshihet materiali për inkontinencë për PAK që kanë nevojë për këtë material. Deri në vitin 2017 në Udhëzimin Administrativ (03/2012) ka qenë e paraparë shpërndarja e materialit nga MSH në bazë të kërkesave nga niveli lokal.

Përgjatë kohës që ky material është shpërndarë në këtë mënyrë, vetëm katër komuna kanë bërë kërkesë për të siguruar këtë material. Kjo sfidë është një simptomë e një mangësie e të dhënave se sa PAK trajtohen në qendrat e mjekësisë familjare të komunave respektive dhe në mungesë të të dhënave, komunat nuk kanë informata për ta bërë kërkesën për këtë material tek MSH. Për ta tejkalluar këtë problem, kartelat shëndetësore të cilat lëshohen nga shtëpitë e shëndetit, duket të kenë një rubrikë të veçantë ku specifikohet lloji i aftësisë së kufizuar – kjo do ta ndihmonte qasjen e stafit mjekësor me personin që pranon shërbim por gjithashtu edhe me ofrimin e shërbimeve dhe konsekuencat e trajtimeve të ndryshme mjekësore.

Që nga viti 2018 kur ka filluar zbatimi për Ligjin për Statusin dhe të Drejtat E Personave Paraplegjik Dhe Tetraplegjik⁸, ka ndryshuar mënyra e përfitimit të këtij materiali. Në kuadër të këtij ligji PAK përfitojnë një shumë pagese në vlerë totale prej 375 euro, përkatësisht 150 euro për personin, 150 për kujdestarin personal, si dhe 75 euro për materialin për inkontinencë, në qoftë se këto dy të fundit janë të nevojshme. Pra, me këtë ligj shpërndarja e materialit për inkontinencë nuk bëhet në mënyrë direkte por me një kompenzim në shumën prej 75 euro shtesë të dedikuara për këtë qështje. Kjo shumë është përcaktuar me hamendësim dhe e rrumbullakësuar, si dhe nuk bazohet në nevojat e përfituesëve sikurse edhe në ndryshimet eventuale të çmimeve të tregut të këtyre materialeve. Pra nuk është marrë paraqysh që llojet dhe shkallët e ndryshme të aftësisë së kufizuar kanë kërkesa të ndryshme që mund të tejkalojnë këtë shumë. Rrjedhimisht për shumicën e përfituesëve kjo shumë nuk është e mjaftueshme.

Gjithashtu, në kuadër të Planit të Veprimit 2013-2015 (Objektiva Specifike 2: Zbulimi i hershëm, identifikimi dhe parandalimi i aftësisë së kufizuar prej kohës paranatale, natale dhe postnatale) është paraparë definimi i listës për pajisjet asistuese bazike për nevojat e PAK. Për një grup të PAK – paraplegjikët dhe tetraplegjikët, lista dhe llojet e pajisjeve asistueseve ndihmëse për lëvizje dhe asistim që do të shpërndahen falas do të përcaktohen me akt nënligjor sipas Ligjit për Statusin dhe të Drejtat E Personave Paraplegjik Dhe Tetraplegjik, Neni 13 “Kujdesi Shëndetësor”⁸. Ky akt nënligjor nuk është nxjerr akoma dhe prandaj kjo listë nuk është definuar deri në Maj të vitit 2018. Deri tani, pajisje asistuese ndihmëse për PAK, nuk ofrohen

⁷ “Sistemi Informativ Shëndetësor ballafaqohet me vështirësi gjatë zbatimit”. KOHA.net, 29 dhjetor 2017.

⁸ Ligji nr. 05/1-067 për Statusin dhe të Drejtat E Personave Paraplegjik Dhe Tetraplegjik

nga asnjë institucion shëndetësor përveç një liste të ngushtë që ofrohet nga organizata jo-qeveritare HandiKos, anëtare e FKAK. Një grup tjetër i PAK – të verbërit, sipas Ligjit për të Verbër, neni 10 “Edukimi dhe Arsimimi”, duhet të përfitojnë pajisje tiflo-teknike dhe tiflo-didaktike për lehtësim të integritit të tyre në shoqëri. Për shpërndarjen e këtyre mjeteve ndihmëse obligohet MPMS, MASHT dhe MSH në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës për sigurimin dhe shpërndarjen e tyre. Sipas përfaqësuesëve të Shoqatës së të Verbërve⁹, këto pajisje nuk shpërndahen.

Vetëdijësimi për shëndetin publik

Broshurat apo fletushkat vetëdijësuese për çështje të ndryshme të shëndetit publik si gripet sezonale, rëndësia e vaksinimit të fëmijëve apo këshilla për shëndetin, janë prezente nëpër sallat pritëse të qendrave të mjekësisë. Por të përjashtuar nga ky informim janë personat e verbër dhe të shurdhër sepse këto materiale nuk përgaditen në shkrimin Brail apo në video në gjuhën e shenjave (përmes DVD).¹⁰

Për këtë arsye, mund të vlerësojmë se MSH si institucion kyq për shëndetin publik nuk e ka arritur objektivën për vetëdijësim të popullatës për vaksinim të fëmijëve me qëllim të arritjes së shkallës 100% të imunizimit, pasi që dy grupe të PAK (të verbërit dhe të shurdhët) nuk e kanë mundësinë ta marrin këtë informatë.

Mirëpo, në realitet që nga viti 2013 e deri në Maj të vitit 2018, nuk është shpërndarë asnjë broshurë apo fletushkë në shkrimin Brail apo DVD me qëllim të informimit të popullatës për rëndësinë e vaksinimit.¹⁰ Kjo do të thotë që personat me aftësi të kufizuar të të pamurit dhe/apo dëgjimit nuk janë pajisur me material vetëdijësues rreth rëndësisë së vaksinimit. Plani i Veprimit 2013-2015 parasheh shumë prej 5000 euro për realizimin e këtij aktiviteti, ndërsa institucionet kyqe për zbatim të tij janë paraparë të jenë MSH, IKPSH dhe QKMF.

Një tjetër kampanjë informative është paraparë të bëhet për PAK dhe familjarët e tyre për kujdesin shëndetësor. Matës i realizimit të këtij aktiviteti është vendosur që të jetë numri i materialeve edukative të shpërndara, përkatësisht: numri i fletushkave, broshurave në Brail dhe DVD për personat e shurdhër. Ky aktivitet nuk është realizuar. Pra material në Brail apo DVD nuk është përgatitur nga 2013 – 2018 për qëllim të kujdesit shëndetësor. Sipas ministrisë, disa materiale për kujdesin shëndetësor shpërndahen në pritore të qendrave mjekësore familjare dhe vende publike në ditë të ndryshme simbolike. Por, ato nuk i shërbejnë dy llojeve të aftësisë së kufizuar, përkatësisht aftësisë së kufizuar dëgjimore dhe vizuale.

Ngritja profesionale e personelit mjekësor

Një tjetër aktivitet i paraparë me Plan të Veprimit 2013-2015, objektivi specifik 3 “Krijimi i shërbimit spinal në QKUK”, është “Ngritja e mëtutjeshme profesionale e personelit mjekësor në

⁹ Konsultime me përfaqësues të Shoqatës e të Verbërve të Kosovës.

¹⁰ Konsultime me përfaqësues të Shoqatës e të Verbërve të Kosovës dhe Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve.

fushën spinale dhe rehabilituese”. Treguesit për realizim të këtij aktiviteti janë: (1) Numri i personelit të trajnuar për këtë shërbim; (2) Numri i pacienteve që kanë marrë shërbime kirurgjikale dhe (3) Numri i pacientëve që kanë marrë shërbime rehabilituese. Sipas zyrtarëve të MSH, 200 infermier janë trajnuar në fushën e përgjithshme të aftësisë së kufizuar, por jo në module enkas për llojet e veçanta të aftësisë së kufizuar. Pra këto module kanë qenë të përgjithësuara dhe kanë përfshirë vetëm disa tema specifike për PAK, sikurse zbulimi i hershëm i aftësisë së kufizuar tek femijët. Megjithatë, këto module nuk e kanë përgatitur stafin profesional mjekësor në fushën e nevojave të target grupit të kësaj strategjie. Edhe pse buxheti i paraparë për këtë aktivitet arrin shumë prej 48,000.00 eurove, zyrtarët e MSH kanë raportuar që nuk kanë të dhëna për numrin e pacientëve të cilët kanë marrë shërbime kirurgjikale dhe kanë qenë përfitues të drejtëpërdrejtë të këtij investimi.

Sa i përket shërbimeve rehabilituese MSH nuk ka asnjë institucion rehabilitues publik. Megjithatë PAK marrin shërbime rehabilituese – ushtrime fizikale, që ofrohen nga spitalet regjionale. Përveç kësaj, PAK përfitojnë shërbime rehabilituese nga OPAK të cilat subvencionohen nga qeveria.

Ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në të dyja Planet e Veprimit parasheh realizimin e një analize të gjendjes shëndetësore dhe nevojave për kujdesin shëndetësor për PAK. Zyrtarët e kësaj ministrie kanë raportuar se në vitin 2015 është realizuar një analizë në bashkëpunim me HandiKos. Kjo analizë rezulton të jetë parciale dhe jo reprezentative meqenëse përfshin vetëm 500 persona. Gjithashtu njësisë e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me Handikos, në vitin 2015 ka realizuar një tjetër analizë, poashtu parciale, e cila trajton vetëm barrierat e qasjes fizike.⁵ Megjithatë në vlerësojmë që nuk janë në përputhje të plotë me aktivitetin siç është paraparë të bëhet analizë e gjendjes shëndetësore për nevojat e kujdesit shëndetësor të PAK.

Sipas MSH⁵, analiza e gjendjes shëndetësore dhe nevojave për kujdesin shëndetësor për PAK ka qenë e paraparë të bëhet brenda 6-mujorit të parë të 2018. Sipas MSH, kjo analizë është paraparë të fokusohet në qasjen fizike në objekte shëndetësore, e cila planifikohet të rritet nga 24% siç ka rezultuar të jetë momentalisht në 30% brenda 2018 (dhe pastaj në 60% në 2019, dhe 100% në 2020). Ndërsa sa i përket hulumtimit për tualete të përshatshme për PAK sipas standardeve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 33/2007, situata akoma nuk dihet se si qëndron sepse hulumtimi është në proces.


Gjithashtu, është paraparë organizmi i së paku dy trajnimeve në vit për ekipet mjekësore dhe infermierët që ofrojnë shërbime shëndetësore për PAK, përkatësisht, Plani 2018-2020, objektiva specifike “Ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore” parasheh se do të bëhet vendosja e këtyre trajnimeve në kurikulat e rregullta të trajnimeve të stafit mjekësor. Aktiviteti në fjalë është realizuar pjesërisht pasi që janë përgatitur module të përgjithësura. Në kuadër të këtyre moduleve janë përfshirë vetëm tema specifike për PAK përderisa këto trajnime është dashur të hartohen në pako të veçanta për secilin lloj të aftësisë së kufizuar. Kjo sepse secili lloj i aftësisë së kufizuar i ka specifikat dhe nevojat relevante. Sipas zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë, në total janë mbajtur gjithsej tetë sosh në vitet 2013 dhe 2014, dhe të njejtat nuk kanë vazhduar në vitet në vazhdim.

Një tjetër aspekt i kujdesit shëndetësor me rëndësi të madhe është identifikimi paranatal dhe zbulimi i hershëm i afësisë së kufizuar. Një objektivë specifike përkatësisht objektiva Specifike numër dy e Planit të Veprimit 2018-2020 i dedikohet kësaj çështjeje dhe parasheh aktivitete që ndihmojnë në identifikimin e aftësisë së kufizuar prej kohës paranatale, natale dhe postnatale. Për këtë është paraparë ndërtimi i laboratorit për diagnostifikim paranatal. Sipas ministrisë, në kuadër të SHSKUK, laboratorit është në ndërtim e sipër por nuk ka informata se kur pritet të përfundohet. Sipas zyrtarëve të MSH nuk dihet se në cilën fazë të realizimit është ndërtimi i laboratorit për diagnostifikim paranatal. Gjithashtu është deklaruar se nuk është mbajtur asnjë trajnim përgaditor i stafit për laboratorin në fjalë. Nga ana tjetër, në asnjë institucion publik shëndetësor në Kosovë nuk bëhet analiza e aminocentezës. Kjo tregon që diagnostifikimi paranatal është i pa mundur.

Për sa i përket aktivitetit të paraparë për rishikim të manualit për identifikim të hershëm të aftësisë së kufizuar, zyrtarët e MSH kanë raportuar të ketë ngecje. Kjo sepse sipas tyre, akoma nuk është krijuar grupi punues për rishikim të manualit. Megjithatë për sa i përket kësaj fushe, mund të konsiderojmë si progres edukimin shëndetësorë të prindërve. Përkatësisht, në zbatimin e programit për edukim shëndetësor rreth shkaktarëve që rezultojnë në aftësi të kufizuar, numri i të trajnuarve nga stafi mjekësor arrin në 303 ndërsa numri i vizitave shtëpiake të realizuara arrin në 12,902, sipas informatave të dhëna nga Ministria e Shëndetësisë.⁵

SISTEMI I MIRËQENIES SOCIALE DHE PUNËSIMI

Personat me Aftësi të Kufizuar janë ndër grupet më të marginalizuara përse i përket punësimit dhe mirëqenies sociale. Puna e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, komunave, institucioneve dhe agjensive të tjera relevante, në implementimin e aktiviteteve të dala nga Strategjia e influencon drejt për së drejti kualitetin e jetës së këtyre personave përse i përket punësimit dhe mirëqenies sociale. Aktivitetet e parapara nën objektivën e dytë e Strategjisë: “Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të barabarta në punësimin e PAK” bien nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve.



Punësimi i PAK

Edhe pse korniza ligjore ekzistuese vlerësohet se përmban dispozita të favorshme për integrimin e personave me aftësi të kufizuar në tregun e punës, verëhet nivel i limituar i implementimit të tyre në praktikë.

Ligji 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara i obligon institucionet publike dhe private që të punësojnë një PAK për çdo 50 të punësuar.¹¹ Mbetet e paqartë se si është bërë kalkulimi i proporcionit 1 me 50 duke marrë parasysh që statistikatat për personat me aftësi të kufizuar janë të mangëta. Sido që të jetë, ky ligj si shumë ligje të tjera, gjen zbatim të limituar në praktikë.

Në kuadër të këtij raporti, nuk kemi arritur të identifikojmë ndonjë sistem të përditësuar të personave me aftësi të kufizuar që punojnë si shërbyes civil. Qeveria nuk ka të dhëna se sa PAK janë të punësuar si shërbyes civil, ndërsa situata në sektorin privat është edhe më vështirë e identifikueshme.

Njëra ndër sfidat kryesore për PAK në Kosovë është punësimi dhe vetëqëndrueshmëria ekonomike. Objektivi i dytë specifik i Planit të Veprimit 2018-2020 i dedikohet tërësisht kësaj çështjeje – pra “Krijimi i kushteve të barabarta në punësimin e PAK”. Specifikisht është paraparë të bëhet vlerësimi expos i zbatimit të Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin dhe Punësimin e PAK.

¹¹ Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Neni 12 “Punësimi Në Tregun E Hapur Të Punës”

Sipas Ministrisë së Punës dhe Mireqenies Sociale¹², është futur në agjendën e viti 2018 për formimin e një ekipi vlerësues për monitorim dhe vlerësim të këtij ligji.

Plani i Veprimit 2013 – 2015 parasheh se gjatë punësimit të PAK, prioritet do t'u ipet grave me aftësi të kufizuar dhe familjeve të cilat kanë së paku dy anëtar me aftësi të kufizuar. Por, zyrtarë nga MAPL kanë deklaruar se nuk ka të dhëna se sa është numri i femrave apo i kryefamiljarëve të punësuar me dy apo më shumë anëtarë të familjes me aftësi të kufizuar. Të njejtit nuk kanë raportuar për ndonjë hap konkret të ndërmarrur për mbledhjen e këtyre të dhënave. Pa mundësi për të pasqyruar nivelin e punësimit të personave me aftësi të kufizuar, e vështirëson procesin e avokimit për çështjen në fjalë.

Përveç kësaj, është paraparë që do të bëhet inkurajimi i punësimit të PAK, duke u dhënë mundësi femrave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të cilat kanë së paku dy anëtar me aftësi të kufizuara. Si indikator i realizimit të aktivitetit janë: numri i femrave me aftësi të kufizuara të punësuar dhe numri i të punësuarve nga familjet që kanë dy apo më tepër anëtarë me aftësi të kufizuara. Se në çfarë forme është bërë inkurajimi i punësimit të PAK, sipas Ministrisë në kuadër Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin dhe Punësimin e PAK është vendosur që kompanitë që nuk punësojnë PAK penalizohen me një pagë (paga minimale në Kosovë) që përcaktohet sipas kritereve mbi standardin e jetesës, e cila derdhet në një fond të veçantë në kuadër të MPMS-së dhe përdoret për programe të aftësimin dhe riaftësimin për punë. Por në mungesë të mekanizmave monitorues për implementim të ligjit dhe të Udhëzimit Administrativ që përcakton mënyrën e gjybitjes për ata që nuk e respektojnë dispozitat e këtij ligji, aplikimi në praktikë i këtij programi është i limituar.

Zyrtarët e MPMS janë pyetur se çfarë përpjekje kanë bërë për ta ngritur nivelin e zbatimit të ligjit për punësim të PAK. Sipas tyre, ZQM është e mandatuara ta bëjë këtë, ndërsa sipas ZQM-së Agjensioni për Punësim duhet ta bëjë këtë.

Objektivi i ardhshëm specifik i objektivit strategjik për punësim, parasheh aftësimin dhe riaftësimin profesional për punësimin e PAK. Për këtë fushë është paraparë të bëhet zgjerimi i profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave të tregut të punës, por kur është pyetur MPMS se çfarë profile të personave me aftësi të kufizuara janë identifikuar që kërkohen në tregun e punës, përgjigja e tyre ka qenë se nuk kanë të dhëna.

Edhe sa i përket aftësimin për tregun e punës, të dhënat mungojnë. Të vetmin numër që e ka ofruar Minsitria është se 30 persona me sindromën Down janë çertifikuar për pjesëmarrje në trajnim për aftësim dhe riaftësim në profile të ndryshme. Ndërsa sa i përket hartimit të programit për zgjerimin e profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave të tregut të punës, MPMS thotë që është duke u punuar në këtë drejtim që konkretisht të bëhet aftësimi/riaftësimi në bazë të aftësisë së kufizuar.¹² Ky i fundit nuk është ndarë me intervistuesit sepse nuk është ende i publikuar.

¹² Intervistë me zyrtarë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale, Departamenti i Punësimit; Departamenti për Mirëqenjen Sociale; Agjensioni i Inspektionit dhe Agjensioni i Punësimit, Prill, 2018.

MPMS në kuadër të praktikës për vetëpunësim dhe aftësim për punë, nga numri i përgjithshëm i përfituesëve, rezervon 10% të vendeve për PAK. Por, një numër i vogël i PAK e shfrytëzojnë këtë mundësi, për shkak se ata persona që kanë qenë përfitues të skemës së pensioneve nga Ligji për Pensionet e Financuara nga shteti, me pjesëmarrje në këtë program diskualifikohen nga e drejta për pension. Pra edhe pse si masë afirmative është menduar si pozitive për çështjen e punësimin të PAK, në thelb është diskriminuese sepse është dekurajuese për përfituesit e skemës, sepse edhe sigurimi i një vendi të punës sezonal, automatikisht i largon PAK nga kjo skemë.

Shërbimet në komunitet

Sa i përket shërbimeve në komunitet, aktivitetet e parapara në plane të veprimit, janë duke u realizuar relativisht mirë në praktikë, me përjashtim të mungesës së angazhimit të një numri të madh të komunave. Në fakt për këtë fushë, MPMS posedon mjaft të dhëna të cilat janë të paraqitura në vijim. Objektiva strategjike “Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e PAK” në Planin e Veprimit 2018 – 2020, përfshin objektivin specifik “Shtirja e shërbimeve në komunitet”, konkretisht vazhdimi i ofrimit të shërbimeve sociale në shtëpitë e komunitetit për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe në institutin special në Shtime.

Numri i fëmijëve përfitues nga shërbimet 24 orë në shtëpitë me bazë në komunitet për fëmijë në Shtime është 10. Të njëjtit vijojnë në mënyrë të rregullt edhe procesin mësimor, në shkollën fillore e cila menaxhohet nga MASHT dhe është afër vendbanimit. Po ashtu nga viti 2009 është duke u zbatuar skema e ndihmës ndaj familjeve me fëmijë me aftësi të përhershme të kufizuara. Të dhënat e fundit nga MASHT deri në fund të muajit Maj 2018 është 2420, i zvogëluar për 300 fëmijë. Kjo ka ndodhur pasi ky numër i fëmijëve nga muaji janar 2018 kanë kaluar në skemën tjetër, tek paraplegjikët dhe tetraplegjikët. Shuma mujore nuk ka pësuar ndonjë ndryshim dhe vazhdon të jetë 100€ për një fëmijë edhe pse sipas zyrtarëve, MASHT ka bërë kërkesë për një rritje simbolike prej 10%, por ende nuk ka aprovim nga Ministria e Financave. Ndërsa në ISSH aktualisht shërbimet 24 orë i marrin 64 persona në gjendje të nevojës sociale dhe janë nga të gjitha komunat e Kosovës. Numri i stafit që ofron shërbime është 70. Po ashtu MPMS i ka të kontraktuara edhe shërbimet e psikiatrit. Klientët janë të strehuar në kohë të caktuar, me qëllim që Qendra për Punë Sociale të bëjnë përpjekje që eventualisht të bëhet bashkimi familjar, pra kthimi në familje, aty ku ekzistojnë mundësitë. Po ashtu shërbime 24 orë për të rriturit me aftësi të kufizuara mendore-gecje në zhvillimin mendor ofrohen edhe në 7 shtëpi me bazë në komunitet, të cilat janë në: Shtime, Ferizaj, Deçan, Dardanë, Vushtrri, Lipjan dhe Graçanicë. Kapacitetet e këtyre shtëpive nuk i plotësojnë kërkesat, (nga 10 shtretër) pasi kërkesat për marrje të këtyre shërbimeve janë më të mëdha se kaq.

Menaxhmenti i institucioneve dhe shtëpive me bazë në komunitet për punë e tyre raportojnë me shkrim në baza vjetore tek MPMS, ashtu siç parashihet edhe me Plan të Veprimit. Kurse shtëpitë me bazë në komunitet kanë kaluar në përgjegjësi të komunave që nga janari i vitit 2016. Tani sipas marrëveshjes së lidhur në mes MPMS dhe komunave, këto shtëpi përmes drejtoratit për shëndësi dhe mirëqenie sociale raportojnë në fund të çdo viti për të arriturat, vështirësitë dhe në tërësi ecurinë e punëve në vija të trasha. Ndërsa sa i përket vazhdimin të ofrimit të shërbimeve në

qendrat rezidenciale në shtëpitë e komunitetit, në 2017 në ISSH janë të regjistruar 64, në shtëpi të fëmijëve 10, kurse në shtëpitë me bazë në komunitet 74. Në 2018 numrat janë të njejtë përveç atyre në shtëpitë me bazë në komunitet që janë rritur në 77.

Një aktivitet tjetër i paraparë, për realizimin dhe menaxhimin financiar të të cilit janë përgjegjëse komunat, është funksionalizimi i shërbimeve sociale në nivel komunal për ofrim të këtyre shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Sipas zyrtarëve të Ministrisë, nga 2017 e deri më sot, OPAK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 11 Komuna.

Në katër mujin e fundit të vitit 2017 stafi i mesëm-infermier, kanë marrë pjesë në trajnime njëditore të organizuara në ISSH, për çdo javë. Në këto trajnime stafi ka përfituar përvojë duke u aftësuar për punën direkt me klientë në mbrojtje rezidenciale. Ndërsa deri në Maj të vitit 2018 akoma nuk është mbajtur ndonjë trajnim.

Shërbimet sociale për PAK ofrohen nga subjekte juridike apo shoqata të licensuara. Aktiviteti i ardhshëm në kuadër të Plani të Veprimit 2018-2020 është edhe licencimi i stafit dhe shoqatave për ofrimin e shërbimeve sociale për PAK. Sipas MPMS, deri më tani në nivel vendi janë licensuar gjithsej 26 subjekte juridike/organizata joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Ndërsa janë licensuar gjithsej 837 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare, prej tyre:

- Në nivelin bazik janë licensuar 363 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare;
- Në nivelin e mesëm janë licensuar 64 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare;
- Në nivelin superior/professional licensuar 410 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare;¹²

MPMS gjithashtu mbikqyr organizatat e licensura për Personat me Aftësi të Kufizuara që ofrojnë shërbime me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës së PAK, përmes kërkesës për paraqitje të raporteve të rregullta. Informatat e komunikuar nga MPMS janë këto: 28 organizata janë të licensuara nga këshilli i përgjithshëm i shërbimeve sociale dhe familjare si dhe komisione të veçanta. Nga 2017 e deri në mars 2018, 27 OJQ dhe 11 shtëpi në komunitet të gjitha raportojnë në MPMS¹². Këto organizata përfitojnë subvencione nga kjo ministri dhe prandaj raportojnë për punën e tyre tek e njejtë.


Fushata vetëdijësuese për punësimin e PAK

Të dyja planet e veprimit parashohin organizimin e fushatave vetëdijësuese për punësimin e PAK. Që nga 2013 e deri në qershor të 2018 janë mbajtur vetëm dy të tilla. Një në vitin 2015 për punësimin e PAK në sektorin privat dhe publik, ku janë shfaqur dy video reklama në katër televizione publike, 24 billboard në 8 qytete, 500 postera, si dhe banera në portale të ndryshme. Dhe e dyta nën planin e veprimit 2018-2020 është mbajtur me mbështetjen e GIZ dhe e ka targetuar një lloj të aftësisë së kufizuar – atë të Down Syndrome.

ARSIMIMI DHE MBËSHTETJA PROFESIONALE

Një numër i madh i fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk ndjekin shkollimin formal, duke mbetur kështu në pozitë edhe më të cënueshme në jetën sociale dhe ekonomike. Kjo ndodh kryesisht për këtë arsye: (1) Niveli i ulët i vetëdijës prindërore/familjare mbi rëndësinë e edukimit, (2) Niveli i ulët i vetëdijës së menaxhmentit shkollor mbi të drejtat ligjore të fëmijëve me aftësi të kufizuara për edukim, (3) Niveli jo i kënaqshëm i kapaciteteve profesionale të mësimitdhënësve dhe mungesa e njohurive të tyre për qasjen pedagogjike ndaj grupeve specifike të aftësisë së kufizuar (4) Mungesa e mësuesëve mbështetës dhe asistentëve personal në shkolla, (5) Mungesa e qasjes fizike dhe qasjes në informacione për fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe (5) Mungesa e materialit shkollor.¹³ Nga të gjitha fushat tematike të trajtuara në këtë raport, çështja e arsimimit të PAK është njëra ndër fushat më të rëndësishme dhe një ndër faktorët më determinues për të ardhmën e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Nga tetë objektiva specifike sa kishte Plani i Veprimit 2013-2015 për objektiven strategjike “Krijimi i kushteve për gjithëpërfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara”, plani i 2018-2020 përfshinë vetëm pesë.



Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Plani i Veprimit 2013-2015 parasheh një mori të objektivave specifike që derivojnë nga objektiva strategjike “Krijimi i kushteve për gjithëpërfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të PAK”. Në këtë raport do të vlerësojmë nivelin e zbatueshmërinë së këtyre aktiviteteve.

Fillimisht, është paraparë të bëhet hulumtim i përgjithshëm për situatën e PAK në arsim dhe një hulumtimin për gjuhën e shenjave, për të cilin MASHT ka qenë i paraparë të jetë institucioni kyq në bazë të Planit të Veprimit. Hulumtimi i përgjithshëm për të cilin janë dedikuar 10,000€, nuk është realizuar. Megjithatë për situatën e PAK në arsim, sipas zyrtarëve të divizionit për fëmijë me nevoja të veçanta të MASHT, i është kërkuar UNICEF-it që në kuadër të hulumtimit që ata i realizojnë, t'i ipet fokus edhe arsimit për PAK. Ndërsa sa i përket hulumtimit për gjuhën e

¹³ Konsultime me organizatat anëtare të FKAQ.

shenjave, nga nëntori i vitit 2017, zyrtarë të MASHT kanë raportuar se janë duke e hartuar dokumentin për arsimin e fëmijëve me dëmtime në dëgjim dhe fokus specifik i është dhënë gjuhës së shenjave.¹⁴ Mirëpo, as ky proces nuk ka përfunduar.

Një tjetër ngecje në realizim të objektivës në fjalë, është adaptimi i programeve për ofrimin e edukimit në shtëpi dhe gjatë trajtimit shëndetësor. I vetmi progres në këtë drejtim ka ndodhur në vitin 2017 në QB “Xheladin Deda” ku ka filluar të ofrohet shërbimi në familje për fëmijët e verbër dhe me dëmtime në shikim, sipas zyrtarëve të MASHT.

Aktivitetet e arritura nën këtë objektivë janë si vijon: (1) përfshirja në SMIA e të dhënave të PAK në shkolla të rregullta, (2) hartimi i standardeve për shkollat gjithëpërfshirëse, dhe (3) botimi i doracaktit “Standardet për shkollat mike për fëmijë” nga MASHT në bashkëpunim me Institutin Pedagogjik të Kosovës, i hartuar në vitin 2016 (edhe pse ka qenë i planifikuar të bëhet në periudhën 2013-2015) dhe në kuadër të shtyllave apo dimensioneve të dokumentit, një dimension i kushtohet gjithëpërfshirjes. Ky dokument jep informacione të mjaftueshme se cilat elemente/standarde duhet t’i ketë shkolla për të qenë gjithëpërfshirëse. Gjithashtu është bërë hartimi i standardeve për PAK për arsimim në nivelin universitar.

Gjithashtu për 2017 dhe 2018 është paraparë të bëhet hulumtim për gjendjen aktuale të vetëdijësimit (megjithëse nuk definohet target grupi) dhe pastaj të organizohet fushatë për ngritjen e vetëdijes për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet parashkollore dhe të hartohet një plan nacional bazuar në rekomandimet e raportit të hulumtimit. E gjithë kjo me qëllim të rritjes së numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucione parashkollore. Por sipas zyrtarëve të MASHT nuk është ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të realizimit të këtij aktiviteti. Sipas tyre, gjatë vitit 2017 nuk ka pasur ndonjë hulumtim specifik vetëm për nivelin parashkollor të arsimit, megjithatë ata shprehen se në planin vjetor të punës së Ministrisë ka aktivitete të përgjithësuara për vetëdijësim.

Bartja e kompetencave për arsimimin e FNV tek komunat

Objektiva e dytë specifike “Bartja e kompetencave në nivel komunal për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore” parasheh emërimin e koordinatorëve të arsimit gjithëpërfshirës nëpër DKA. Institucioni zbatues për këtë aktivitet janë komunat (MASHT është institucion mbështetës) disa prej të cilave (përkatësisht 28 prej 38) kanë arritur që të punësojnë nga një zyrtarë të arsimit gjithëpërfshirës dhe t’i trajnojnë të gjithë zyrtarët për ngritje të kapaciteteve të autoriteteve komunale për menaxhim të arsimit të FNV-ve. Ndërsa sa i përket përcaktimit të linjës së veçantë dhe formulës financiare për FNV, asnjë nga komunat nuk ka linjë buxhetore të ndarë për FNV, ndërsa MASHT ka linjë të veçantë vetëm për QB-të.¹⁴

Objektiva e tretë parasheh themelimin e sistemit apo mekanizmit mbështetës për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në anën tjetër parasheh emërimin dhe funksionalizimin e ekipeve për vlerësim në nivel komunal në shtatë komunat më të mëdha. Kjo pikë nuk korresponon me

¹⁴ Intervistë me zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Divizioni për Arsimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, Prill, 2018.

vetë Udhëzimin Administrativ 07/2012 për themelimin e grupeve vlerësuese, sipas të cilit sistemi do të funksionalizohet në të gjitha komunat e Kosovës. Por as Udhëzimi Administrativ nuk është respektuar plotësisht, duke marrë parasysh që deri në maj të 2018, ekipet vlerësuese janë funksionale vetëm në 14 komuna, ndërsa me 14 të tjera është duke punuar FKAK që të mbështesë funksionalizimin e tyre. Në vitin 2017 MASHT ka nxjerr Udhëzimin e ri Administrativ për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, i cili ndryshe nga Udhëzimi i vjetër (07/2012), parasheh edhe kompensim për ekipet vlerësuese. Megjithëse, deri tash asnjë ekip nuk është kompensuar për punën e tij.¹⁵

Më tej, parashihet ngritja e kapaciteteve të këtyre të punësuarve për mbarëvajtjen e sistemit mbështetës në nivel qendror, komunal dhe institucionet shkollore. Sipas informatave të dhëna nga MASHT, të gjitha ekipet vlerësuese janë trajnuar për t'u funksionalizuar dhe gjatë vitit 2015-2017 në 10 komuna është investuar në trajnimin me module ku janë përfshirë të gjithë anëtarët e ekipeve vlerësuese, ndërsa 7 prej tyre janë pajisur edhe me dhomat e vlerësimit sipas standardeve, në bashkëpunim me Save the Children. Nga ana tjetër, edhe FKAK me mbështetjen e UNICEF, ka organizuar pesë takime për shkëmbim të eksperiencave në mes të ekipeve funksionale dhe atyre jo-funksionale.

Gjithashtu sipas Ministrisë, të gjithë koordinatorët e arsimit gjithëpërfshirës janë trajnuar, ndërsa sa i përket përgatitjes së udhëzuesëve për funksionimin e ekipeve vlerësuese dhe të koordinatorëve, edhe pse me katër vite vonesë, mund të vlerësojmë se ka progres. Në vitin 2017 janë hartuar instrumentet për shkolla dhe ekipet vlerësuese pedagogjike në komuna bazuar në ICF (International Classification Functioning Children & Youth). Instrumentet nga muaji Maj 2018 kanë filluar të pilotohen në 8 komuna dhe 16 institucione arsimore.

Sipas zyrtarëve të MASHT janë organizuar edhe punëtori me komuna për ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe bartjen e kompetencave menaxhuese të arsimit gjithëpërfshirës tek ato. Por për këtë proces, sipas FKAK-së nuk është njoftuar shoqëria civile përfshi organizatat për mbrojtjen e të drejtave të PAK që janë partnere kyçe të institucioneve shtetërore për fushën e caktuar.

Identifikimi dhe edukimi i hershëm

Në Planin e Veprimit 2013-2015 objektiva numër pesë parasheh krijimin e mekanizmave ndër-sektoriale në nivel qendror dhe komunal për identifikim dhe intervenim të hershëm. Sipas zyrtarëve të MASHT, projektligji i ri për zhvillim në fëmijërinë e hershme është në diskutim publik dhe me të një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet intervenimit të hershëm. Ndërsa analiza për gjendjen aktuale të FNV është realizuar në një hulumtim në bashkëpunim me Save the Children dhe Fakultetin e Edukimit. Baza e të dhënave për identifikim dhe intervenim të hershëm është krijuar dhe menaxhohet dhe azhurnohet nga SMIA në MASHT.

Gjithashtu është paraparë zhvillimi i fushatave vetëdijësuese për identifikimin dhe intervenimin e hershëm. Deri tani janë mbajtur një numër i fushatave, ndër të cilat:

- Java e arsimit për të gjithë “Arsimi dhe aftësia e kufizuar” ku është theksuar nevoja e avancimit të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin arsimor.

¹⁵ Konsultime me FKAK

- Shënimi i ditës së 1 Qershorit me nxënësit e qendrave burimore në gjithë Kosovën, përmes garës në letërsi dhe art figurativ.
- Fushata për arsim gjithëpërfshirës në tetor të vitit 2014 (3 javë) e organizuar në bashkëpunim me Save The Children. Gjatë kësaj fushate janë transmetuar 3 video spote për arsim gjithëpërfshirës në televizionet nacionale, janë organizuar 3 aktivitete me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

Gjithashtu sipas MASHT, është bërë hartimi dhe botimi i broshurave, fletëpalosjeve dhe posterave me informacione rreth rëndësisë së arsimit gjithëpërfshirës dhe shërbimeve që ofrojnë QB-të – megjithëse nuk ka pasur broshura në shkrimin Brail apo DVD me gjuhë të shenjave, që do të mundësonin qasjen e personave të verbër dhe të shurdhër.

Sa i përket trajnimeve për drejtues e IP, shkollave dhe stafit edukativ për identifikim dhe intervenim të hershëm, janë mbajtur 8 trajnime me drejtues të IP me 160 pjesëmarrës. Por trajnimet që janë paraparë të mbahen për prindër për identifikim dhe intervenim të hershëm, nuk janë mbajtur sipas zyrtarëve të MASHT. Po ashtu, themelimi i qendrave për identifikim dhe intervenim të hershëm nuk ka ndodhur, dhe për këtë, MASHT deklaron se kjo nuk bie nën mandatin e tyre por në atë të MSH dhe MPMS. Ndërsa ekspert të çështjes nga shoqëria civile¹⁵, thonë se është përgjegjësi ndërministrrore që nënkupton edhe MASHT-in. Iniciativa duhet të mirret nga MPMS si institucion bartës i procesit por në koordinim me MASHT dhe MSH.

Për periudhën 2018-2020, Plani i Veprimit me objektivën e parë parasheh krijimin e mekanizmave për identifikim dhe edukim të hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara përkatësisht krijimin e një baze për mbledhjen e integruar të të dhënave për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në IP dhe shkolla. Sipas MASHT, të dhënat mbledhen nga sistemi SMIA, për përdorim të së cilës është paraparë që të bëhet trajnim i përdoruesve. Sipas ministrisë në secilën shkollë dhe në secilën komunë është nga një person i trajnuar në SMIA, si dhe është hartuar udhëzuesi për regjistrim të fëmijëve me aftësi të kufizuara që gjendet në web faqe të MASHT.

Por memorandumimi për “Krijimin e një baze për mbledhjen e integruar të të dhënave për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në IP dhe shkolla” që është paraparë të nënshkruhet në mes të MASHT, MPMS, MSH nuk është nënshkruar akoma deri në këtë periudhë dhe për këtë, sipas MASHT, përgjegjëse është ZQM pasi që aktiviteti kërkon koordinim ndërministror dhe vetëm ZQM ka mandat për këtë.

Zhvillimi i Qendrave Burimore

Në Kosovë operojnë pesë qendra burimore – dy nga të cilat janë në Prizren: “Lef Nosi” dhe “Nëna Terezë”; një në Pejë: “Xheladin Deda”; një në Prishtinë: “Përparimi”; dhe një në Mitrovicë “Nëna Terezë”. Këto qendra luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Një objektivë specifike në këtë sektor i dedikohet fuqizimit dhe zhvillimit të QB-ve si qendra të dijes dhe ekspertizës për të ofruar shërbime këshillimi dhe të mbështetjes për FNV. Ndër të tjera, parashihet punësimi i instruktorëve të gjuhës së shenjave dhe

asistentëve të klasave për fëmijët e shurdhër. Kjo nuk është arritur sipas Planit të Veprimit 2013-2015 sepse deri në vitin 2015 nuk ka pasur asistent dhe instruktor të kualifikuar. Në vitin 2016 është punësuar një instruktor në QB “Nëna Terezë” në Prizren.

Progres është bërë me shtimin e një shërbimi shtesë në 2017 në QB “Xheladin Deda” për intervenim të hershëm në familje. Por ky mbetet i vetmi progres sa i përket krijimit të shërbimeve të reja mbështetëse brenda QB-ve. Ndërsa sa i përket zhvillimit profesional të stafit të QB-ve sipas MASHT i gjithë stafi i QB-ve është trajnuar nga programe të ndryshme që nga viti 2002.

Plani i Veprimit 2013-2015 parasheh edhe rritjen e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin e mesëm të lartë me fokus në AAP dhe arsim jo formal, dhe organizimin e punës praktike në AAP të nxënësve përmes lidhjes së marrëveshjeve me biznese nga QB dhe pajisjen e punëtorive në QB me mjete adekuate për punë praktike. Sipas minsitrisë të gjitha qendrat janë të pajisura me punëtori për punën praktike dhe deri tani 6 marrëveshje janë lidhur në mes të bizneseve dhe QB-ve, megjithatë, sipas monitorimit të FKAK jo të gjitha QB-të kanë punëtori.

Plani i veprimit 2018-2020 parasheh edhe rritjen e numrit të shërbimeve mbështetëse që ofrojnë QB-të për 40%. Por, QB-të vazhdojnë të ofrojnë numrin e njejtë të shërbimeve, e që janë shtatë llojet e shërbimeve pedagogjike si në vijim: mbështetjes për shkolla të rregullta me mësuesit udhëtues, shërbimi i vlerësimit të brendshëm, njësia e shtypjes në Brail, shërbimi për trajnime të mësimitdhënësve të shkollave të rregullta, shërbimi për intervenim të hershëm në familje për fëmijët e verbër, dhe dhomat sensorike.

Integrimi i FNV në shkolla të rregullta

Fëmijët me aftësi të kufizuar, vazhdimisht integrohen në shkolla të rregullta, qoftë plotësisht apo pjesërisht. Megjithëse ekzistojnë dallime në mes të grupeve të aftësisë së kufizuar për sa i përket integrimit të tyre në shkolla të rregullta. Në këtë kontekst mund të përmendim fëmijët e shurdhër dhe ata të verbër të cilët në mungesë të qasjes në informacione ngecin në procesin e integrimit në shkolla të rregullta.

Për procesin e integrimit është paraparë implementimi dhe monitorimi i planit të integrimit të FNV. Por sipas zyrtarëve, këto plane nuk janë zbatuar dhe nuk ka informata të mëtutjeshme rreth tyre. Gjithashtu, në situatën ekzistuese në shkolla të rregullta ku një mësues i ka afër 30 nxënës, është e vështirë të pritët nga ai/ajo t’i kushtojë vëmendjen e nevojshme fëmijës me nevoja të veçanta. Pra ky proces ka ngecje për shkak të mungesës së asistentëve profesional (personal për disa lloje të aftësisë së kufizuar) në shkolla të rregullta që do të mbështesnin gjithëpërfshirjen e FNV-ve. Madje, ka shumë raste kur në mungesë të asistentëve prindërit paguajnë asistentë privat brenda shkollave publike.

Sa i përket asistentëve profesional në shkollë, ka pasur ngecje nga ana e institucioneve në këtë drejtim në iniciativën e vetë marrë nga MASHT në vitin 2015 për trajnimin dhe certifikimin e 15 asistentëve dhe instruktorëve të gjuhës së shenjave. Këta 15 persona janë trajnuar nga MASHT

për t'u punësuar më pas në QB. Marrëveshja ka qenë që minimumi 2 instruktorë dhe 8 asistentë të punësohen, por deri tani është punësuar vetëm një në QB në Prizren.

Ndërsa formimi i forumit të mësimdhënësve për arsim gjithëpërfshirës me qëllim të shkëmbimit të përvojave, prodhimit të materialit mësimor, bashkëpunimit profesional në bazë të ekspertizës, nuk është realizuar, sipas zyrtarëve të MASHT. Mirëpo, progres është bërë në arritjen e marrëveshjes me Fakultetin e Edukimit që praktika profesionale e studentëve të kryhet në QB, klasa burimore apo në IP dhe shkolla ku ka FNV. Por nuk dihet se sa studentë të fakultetit të edukimit marrin pjesë në praktika profesionale në QB apo sa në shkolla ku ka FNV sepse MASHT nuk i posedon këto të dhëna.

Objektiva tjetër specifike parasheh ngritjen e kapaciteteve të QB-ve, përkatësisht trajnimin e trajnerëve dhe mësimdhënësve të QB për përdorimin e PIA. Momentalisht janë rreth 8 trajner për PIA ndërsa numri i mësuesve që kanë kaluar nëpër trajnime është mbi 5000, sipas zyrtarëve të MASHT. Ndërsa për nivelin e përdorimit të PIA-s nuk ka të dhëna aktualisht, por me SMIA është shtuar edhe një modul ku kërkohet nga shkollat të përfshijnë të dhënat për fëmijët që kanë PIA. Trajnimi i mësimdhënësve të QB për mësimdhënie sipas fushave të aktiviteteve për fëmijët me dëmtime të shumëfishta dhe dëmtime të rënda – sipas zyrtarëve të MASHT, gjithsej 137 mësimdhënës janë trajnuar në këtë program.

Kuadri profesional për arsimin gjithëpërfshirës

Objektiva Specifike 8 nga plani i veprimit 2013-2015 parasheh “krijimin e kuadrit profesional në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, rritjen e stafit arsimor mbështetës për arsimin e FNV në arsim, përfshirjen e arsimtarëve në programin e aftësisht, rikualifikimin e mësimdhënësve pa shkëputje nga puna, dhe rritjen e lëndeve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës”. Rreth asaj se ku qëndron ky proces, MASHT nuk ka raportuar të ketë informata.

Vlerësimi i nevojave dhe kapaciteteve për rritjen e numrit të edukatorëve mbështetës, është paraparë të bëhet në 2017, por sipas MASHT është akoma në proces, prandaj nuk ka raport të vlerësimit as deri në mesin e vitit 2018. Megjithatë, progres është arritur në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve parashkollore për punën me fëmijë me aftësi të kufizuara. Përkatësisht, sipas MASHT, janë mbajtur trajnime për 475 mësimdhënës dhe 175 edukatorë në fushën e arsimit gjithëpërfshirës dhe përdorimin e PIA-së.

Objektivi tjetër për 2018-2020 parasheh “krijimin, fuqizimin dhe përmirësimin e shërbimeve të mekanizmave ndër-sektorial dhe mekanizmave tjerë mbështetës për shkollën gjithëpërfshirëse”. Në këtë drejtim ka progres sidomos në funksionalizimin e ekipeve vlerësuese pedagogjike në komuna për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Megjithatë, jo në të gjitha komunat. Sipas MASHT, deri tani 28 komuna i kanë themeluar ekipet vlerësuese, në 22 nga ato ekipet janë funksionale ndërsa në 6 tjera nuk janë. Megjithatë, sipas FKAK, më shumë se 10 komuna janë cilësuar si jo-funksionale bazuar në takimet direkte me ekipet në fjalë.

Në anën tjetër, ngecje ka pasur edhe në aktivitetin për punësim dhe trajnim të asistentëve dhe instruktorëve të gjuhës së shenjave. Gjatë tërë vitit 2017 është punësuar një instruktor dhe në 2018 planifikohet të punësohet vetëm edhe një tjetër. Megjithatë, progres është arritur në

përpilimin e analizës për pilotimin e përdorimit të KNF-së në sistemin e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, sipas MASHT në bashkëpunim me ekspertët e Universitetit të Bolonjës dhe Padovës në Itali është bërë analiza e situatës dhe bazuar në të është krijuar një pako me instrumente dhe udhëzues për vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara i cili do të përdoret nga shkollat dhe ekipet vlerësuese. Për më tepër, sipas MASHT, trajnime dy-ditore për ekipet vlerësuese për vlerësimin e nxënësve të shurdhër duke përfshirë edhe shkallën e njohurisë së gjuhës së shenjave me qëllim që të arrihet njohja e gjuhës së shenjave nga të gjithë fëmijët e shurdhër, janë mbajtur për 75 mësimdhënës, prej tyre 47 janë në trajnimin 2 vjeçar për gjuhën e shenjave. Të gjithë janë staf i QB “Nënë Tereza” në Prizren dhe 28 nga QB tjera kanë marrë pjesë në trajnim. Në 2018 programi i trajnimit vazhdon akoma.

Ngritja e vetëdijes shoqërore mbi arsimin gjithëpërfshirës

Objektiva tjetër specifike parashihet ngritjen e vetëdijes së shoqërisë mbi arsimin gjithëpërfshirës për FNV. Përkatesisht është paraparë të organizohen fushata të vetëdijesimit si spote në TV, shkrimet në gazeta, kampet verore, aktivitetet sportive, debatet, tryezat e rumbullakëta, dhe aktivitetet verore. Deri tani janë organizuar këto fushata:

- Java e arsimit për të gjithë” me temën “Arsimi dhe aftësia e kufizuar” ku vihet theksi dhe nevoja e avancimit të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin arsimor.
- “1 Qershori” aktiviteti qendror është shënuar me nxënësit e QB në gjithë Kosovën, përmes garës në letërsi dhe art figurativ.
- Fushata për arsim gjithëpërfshirës në vitin 2014 e organizuar në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare Save The Children. Gjatë kësaj fushate janë transmetuar 3 video spote për arsim gjithëpërfshirës në televizionet nacionale, dhe janë organizuar 3 aktivitete me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

Ndërsa hartimi dhe botimi i broshurave, fletëpalosjeve dhe postereve me informacione rreth rëndësisë së arsimit gjithëpërfshirës, shërbimeve që ofrojnë QB-të dhe organizimi i punëtorive me komuna për ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe bartjen dhe menaxhimin e kompetencave të arsimit special/gjithëpërfshirës, nuk ka ndodhur.

Nga ana tjetër, Ministria bashkëpunon me QB-të për shënimin e datave ndërkombëtare për promovimin e të drejtave të FNV. Konkretisht, çdo vit organizohen aktivitete me fëmijë për shënimin e ditës ndërkombëtare të Aftësisë së Kufizuar. Progres gjithashtu është bërë në prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës, konkretisht sipas MASHT janë prodhuar këto materiale për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës (gjenden në web-faqen e MASHT-it):

- Hartimi dhe botimi i dokumentit “Financimi i arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara”, ku do të publikohet një formulë që do të shërbejë për ndarjen e buxhetit sipas llojeve dhe sipas shkallës së aftësisë së kufizuar (e lehtë e mesme dhe e rëndë, shumëfishtë), dhe do të integrohet në formulën e re të arsimit e cila është në plan të rishikohet nga viti 2018;

- Rishikimi dhe botimi i dokumenti “Plani Individual i Arsimit për nxënësit me aftësi të kufizuara”;
- Përgatitja dhe botimi i librit ”Materiale të prodhuara dhe të modifikuara për mësimdhënie dhe mësim nxënie” i përgatitur në bashkëpunim me QB “Përparimi”. Materiali i dedikohet mësimdhënësve për punë me nxënësit me nevoja të veçanta dhe atyre me vështirësi në të nxënë dhe i posedon 160 lloje të materialeve didaktike që mund t’i përgatisë vetë mësimdhënësi me materiale ricikluese.
- Hartimi dhe botimi i dokumentit “Udhëzues për mësuesit udhëtues“ i cili jep udhëzime konkrete për mësuesit udhëtues që janë në kuadër të QB-ve se si të mbështesin nxënësit me AK në shkolla të rregullta;
- Përgatitja e dorëshkrimit “Dokumentimi i përvojave pozitive në shkolla” nga Divizioni për Arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta në bashkëpunim me QB.
- Finalizimi i programit “Mësimdhënia bazuar në fusha të aktiviteteve” i cili ju dedikohet fëmijëve me nevoja të veçanta të rënda dhe të shumëfishta. Programi po zbatohet në 6 QB dhe shkolla të rregullta nga viti shkollor 2016/2017.
- Përgatitja e dokumentarit dhe spotit “Arsimim i drejtë i secilit fëmijë”, dedikuar rëndësisë se arsimimit të nxënësve me nevoja të veçanta dhe inkurajimit të prindërve t’i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë, i realizuar në bashkëpunim mes Divizionit për Arsim me nevoja të veçanta me Save the Children dhe Handikos. Transmetuar në televizionet nacionale.
- Hartimi i dokumentit “Udhërrëfyesi mbi diversitetin dhe gjithëpërfshirjen në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë” me përkrahjen e Projektit të binjakëzimit – BE, dhe jep një pasqyre të gjendjes sa i përket gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor.
- Hartimi dhe botimi i dokumentit “Doracak mbi gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim”. Ky doracak ju dedikohet Drejtorive Komunale të Arsimit dhe prindërve me qëllim të informimit të tyre për të drejtat e nxënësve me nevoja të veçanta dhe shërbimet arsimore që ofrohen për këtë kategori. Por nuk dihet numri i saktë i prindërve që e kanë marrë këtë broshurë, apo qasja për prindërit në zona rurale.

Cilësia e mësimdhënies dhe arsimit gjithëpërfshirës


Objektivi i tretë i planit të veprimit 2018-2020 parasheh krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për gjithë përfshirje në shkollë dhe komunitet, parasheh një mori aktivitete. Fillimisht, parasheh shëndërrimin e klasave të bashkangjitura në dhoma të burimeve funksionale me qëllim të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasë të rregullta dhe rritjen e numrit të mësimdhënësve mbështetës. 42 klasa janë shndërruar në dhoma burimore dhe numri i njejtë i mësimdhënësve kanë kaluar në mësimdhënës mbështetës, sipas informatave të dhëna nga zyrtarët e MASHT.

Është paraparë edhe përcaktimi i shkollave bilinguale që do të ofrojnë arsim për fëmijët me dëmtime në dëgjim dhe të shurdhër me qëllim të rritjes së përfshirjes së tyre në shkolla të rregullta. Sipas MASHT, është duke u punuar në bashkëpunim me SHKSH dhe partner tjerë dokumenti për “Arsimin e fëmijëve me dëmtime në dëgjim”. Në 2017, sipas MASHT 183 nxënës me dëmtime në dëgjim janë bërë pjesë e shkollave të rregullta.

Tutje, parashihet ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në arsimin gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar. Përkatësisht, planifikohet të bëhet trajnimi i mësimdhënësve në arsimin gjithëpërfshirës, hartimi dhe zbatimi i programit të trajnimeve për arsimin gjithëpërfshirës me qëllim të ngritjes së gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim. Edhe në këtë aspekt ka progres, sipas MASHT në 2018 janë trajnuar 475 mësimdhënës, por nuk dihet se kur pritet të arrihet gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim. Kjo sepse, sipas Ministrisë, është proces dhe nuk mund të definohet me vite pasi që gjithëpërfshirja në edukim përveç përfshirjes fizike ka edhe komponentën e cilësisë e cila merr kohë për tu arritur dhe vlerësuar.

Ndërsa aktiviteti për funksionalizim të arsimit joformal në kuadër të QB-ve dhe në shkollat e rregullta, nuk ka ndodhur. Nuk dihet se sa shkolla të rregullta dhe QB e kanë funksionalizuar arsimin joformal. Ndërsa sa i përket numrit të kandidatëve të përfshirë në mësim joformal, një konkurs është shpallur në QB “Xheladin Deda” dhe ka pasur vetëm një kandidat, sipas Ministrisë.

INFRASTRUKTURA LIGJORE DHE TË DREJTAT E PAK



Fusha e aftësisë së kufizuar rregullohet me një numër të ligjeve në fuqi. Disa prej tyre janë përmbajtësore dhe kanë dispozita të favorshme për PAK, por ka edhe prej tyre që përdorin gjuhë dhe dispozita diskriminuese, ndërsa në përgjithësi gjejnë zbatim të limituar në praktikë.

Ligjet eksiztuese që prekin fushën e aftësisë së kufizuar

Ligjet e listuara në tabelën e mëposhtme, e përbëjnë kornizën ligjore që e rregullon fushën e aftësisë së kufizuar në Kosovë:

Nr.	LIGJI	HYRJA NË FUQI	PËRMBLEDHJE E FUSHËS QË RREGULLON
1.	Ligji 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë	2003	<i>Shfuqizuar në 2014</i>
2.	Ligji 03/L-022 për përkrahjen materiale të familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar	2008	Ofron mbështetje financiare me 100 euro në muaj për familjet që kanë fëmijët me aftësi të kufizuar 1- 18 vjec .
3.	Ligji 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e PAK	2008	Obligon institucionet publike dhe private që të punësojnë një PAK për çdo 50 të punësuar.
4.	Ligji 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës	2008	Promovon politika përfshirëse për integrimin e personave me dobësi dhe aftësi të kufizuara në sistemin arsimor.
5.	Ligji 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës	2011	Obligon MASHT, komunitet dhe të gjitha institucionet arsimore për ofrim të të drejtave të barabarta për shkollim të gjithë fëmijëve në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike.
6.	Ligji 04/L-092 për personat e verbër	2012	Garanton kompensim material për të verberit e grupit të parë përfshirë edhe shoqeruesin e tij/saj, në vlerë prej 250 Euro. Ndërsa të verberit e grupit të dytë, kompenzohen me shumën prej 125 euro në muaj. Jep perparësi në punësim në kushte të favorshme.

7.	Ligji 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti	2014	Përfituesit e ligjit për pensionet e PAK, tani përfitojnë pension të paaftësisë së përhershme nga ky ligj, i cili i konsideron të gjithë PAK nga 18 deri në 65 vjeç si të paaftë për punë, dhe ju ofron shumën prej 75 euro në muaj përderi sa këta persona janë të pa punësuar (edhe sigurimi i një pune sezonale, i përjashton PAK nga kjo skemë).
8.	Ligji 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi	2015	Definon mosdhënien e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar si diskriminim. Obligon punëdhënësit të ndërmarrin masa të duhura që t'i mundësojnë personit me aftësi të kufizuar të ketë qasje, të marrë pjesë apo të avancohet në punësim, trajnim, përveç nëse kjo masë përbën ngarkesë joproporcionale për punëdhënësin.
9.	Ligji 05/L-025 për kujdesin mendor	2015	Rregullon fushën e kujdesit mendor.
10.	Ligji 05/L-018 për Provimin përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore	2016	Siguron që kandidatët me nevoja të veçanta i nënshtrohen provimit përfundimtar dhe të maturës sipas kushteve dhe kritereve të përshtatura ndaj nevojave të tyre. Pavarësisht se deri më tani nuk ka asnjë Test që bazohet në specifikat e komunitetit.
11.	Ligji 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik	2016 (Zbatueshmëria ka filluar me vonesë më shumë se një vjeçare)	Regullon statusin dhe të drejtat e personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo të sipërme. Përcaktohen të drejtat në beneficione të përfituesve të këtij ligji si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave.

Fushës së infrastrukturës ligjore i dedikohet njëra nga pesë objektivat strategjike të Strategjisë, dhe nga tri objektiva specifike në të dyja planet e veprimit. Institucionet kyqe të mandatuara për zbatim të aktiviteteve që qojnë në përmbushje të objektivave janë ZKM, MPMS, MASHT, MPB, dhe MD, ndër të tjerash.

Në fakt, plani i veprimit për vitet 2013-2015 parasheh ndryshimin dhe plotësimin e kornizës aktuale ligjore për PAK, konkretisht ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar¹⁶, dhe ngritjen e vlerës së përfitimit apo shumës së pensionit. Ligji në fjalë, i vitit 2003 është shfuziquar dhe në 2014 është aprovuar ligji i ri për skemat pensionale të financuara nga shteti, i cili i përfshinë personat me aftësi të kufizuar.¹⁷

Nga ligji i 2003 kanë përfituar të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar, ndërsa ligji për skemën pensionale i përjashtoi personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik sepse këto dy kategori përfitojnë nga ligje të veçanta (Ligji 04/L-092 për personat e verbër dhe Ligji 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik). Në esencë mbetet ligji i njejtë por kalon nga një ligj sektorial në ligj të unifikuar si skemë pensionale shtetërore.

Sipas Ligjit 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, çdo person me aftësi të kufizuar, konsiderohet si i pa-aftë për punë. Pra këto dipozita përveç që janë tejet diskriminuese dhe denigruese, janë gjithashtu dekurajuese për PAK që të kërkojnë punë dhe të kontribuojnë në shoqëri me ato aftësi që i posedojnë. Nëse një PAK punësohet, automatikisht i heqet e drejta në këtë pension, pa marrë parasysh se sa është në gjendje të punojë dhe fitojë në tregun e punës. Për më tepër, procesi i draftimit të këtij ligji ka shkuar pa konsultime publike të organizatave të fushës së aftësisë së kufizuar.

Me ligjin e ri PAK vazhdojnë që të përfitojnë shumën e njejtë që nga viti 2014, e cila është rritur nga 60 në 75 Euro. Edhe pse kushtet ekonomike si inflacioni, fuqia blerëse, rritja ekonomike, ndryshimi në koston mujore të shportës së konsumatorit, kanë ndryshuar, rritja e fundit ka qenë në vitin 2014.

Problem i ngjashëm me logjikën e skemave përfituese, është ligji për përkrahjen materiale të familjeve me fëmijë me AK. Nga mosha 1 vjeç deri në moshën 18 vjeç fëmijët me sindromen Down, me Autizëm, dëmtime tjera intelektuale dhe me dëmtime fizike, përfitojnë 100 euro në muaj, kurse pas kësaj moshe hyjnë në ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe përfitojnë 75 euro në muaj. Pra pas moshës 18 vjeçare dhe me rritjen e nevojave, një individ me aftësi të kufizuar në momentin që arrin moshën e rritur, përfiton 25 euro më pak në muaj për ta mbështetur vehten ekonomikisht, dhe është i dekurajuar për të kërkuar punë sepse automatikisht përjashtohet nga skema.

Nga ana tjetër, ligji për përkrahjen materiale të familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar, nuk ofron ndonjë mbështetje tjetër psiko-sociale për prindërit, përveç asaj financiare. Hulumtime të ndryshme kanë treguar që prindërve dhe familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar, ju mungojnë shërbimet specifike që i mbështesin këta të fundit në qasjen dhe përkrahjen ndaj fëmijëve të tyre.¹⁸

Ndërsa Plani i veprimit 2018-2020 parasheh një iniciativë për ndryshim/plotësim të kornizës ligjore që e rregullon këtë fushë. Në vazhden e kësaj, është bërë plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit

¹⁶ Ligji Nr. 2003/23 Për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë


¹⁷ Ligji Nr. 04/L-131 Për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

¹⁸ “Understanding the Situation of Children with Disabilities in Kosovo Through Thier Own Voice”. Geci & Xheladini, janar 2017.

për Aftësim Riaftësim dhe Punësim të PAK në vitin 2016. Nga ky ligj kanë derivuar dy Udhëzime Administrative, përkatësisht: (1) Për vlerësim të aftësisë së mbetur për punë, dhe (2) Për punëdhënësit të cilët nuk punësojnë PAK. Por asnjëri nuk është në fuqi deri në këtë periudhë.

Si pjesë e iniciativës për plotësim dhe ndryshim të kornizës ligjore për PAK, Shoqata Down Syndrom Kosova me mbështetje të Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, OPAK dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka iniciuar procesin e krijimit të një bazë ligjore gjithëpërfshirëse, të mirëfilltë dhe funksionale për personat me aftësi të kufizuar, përmes hartimit të një Projektligji Gjithëpërfshirës. Në kuadër të kësaj nisme, është hartuar koncept– dokumenti për draftimin e Ligjit Gjithëpërfshirës për trajtim të barabartë për të gjithë personat me aftësi të kufizuar. Pas një sërë punëtorive të përbashkëta të akterëve relevant, është arritur të finalizohet koncept- dokumenti në fjalë, të futet në planin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe të përcillet në dëgjim publik. Megjithatë, situata politike, dhe rikonstituimi i organeve të reja qeveritare në vitin 2017, ka penguar procedimin e këtij koncept-dokumenti për miratim në qeveri. Rrjedhimisht, pjesa më e madhe e grupeve të aftësisë së kufizuar (duke përjashtuar personat e verbër dhe ata me para dhe tetra plegji – të cilët marrin mbrojtje ligjore nga ligjet e veçanta respektive) kanë mbetur pa mbrojtje më të avancuar ligjore e cila trajton në mënyrë të barabartë të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar. Ligjet aktuale për sa i përket fushës së aftësisë së kufizuar vazhdojnë të jenë të segreguara nën një kornizë ligjorë të pa harmonizuar. Situata e tillë legjislative, rezulton me mohim dhe mosrespektim të të drejtave njerëzore të personave me aftësi të kufizuara, të cilat garantohen me Kushtetutë.

QASJA, INFORMIMI DHE SISTEMI I UNIFIKUAR I TË DHËNAVE



Të drejtat e PAK, duke filluar nga ato bazike siç është qasja fizike në objekte të institucioneve publike dhe ato shëndetësore shkelen në masë të madhe në vendin tonë. Siç u përmend në pjesën e raportit që trajton temën e shëndetësisë, vetëm 24% të objekteve shëndetësore kanë qasje fizike për PAK⁵. Shumica e institucioneve publike në nivel lokal dhe qendror, nuk ofrojnë qasje në informata për disa kategori të PAK, dhe pak fushata publike e kanë në konsideratë faktin se ka lloje të aftësisë së kufizuar tek të cilat nuk përçohet mesazhi përmes mediave tradicionale dhe elektronike. Për më tepër, edhe më shqetësues është fakti që për shumë aspekte të jetës së PAK nuk ka të dhëna dhe aktivitetet e parapara në Strategji për mbledhjen e tyre nga trupa të ndryshëm të institucioneve publike, deri tani kanë mbetur kryesisht në letër. Për shembull:

- Nuk ka të dhëna se sa PAK janë të punësuar në sektorin publik apo privat;
- Nuk ka të dhëna se sa PAK janë në kërkim të punës;
- Nuk ka të dhëna se sa është numri i femrave apo i kryefamiljarëve të punësuar me dy apo më shumë anëtarë të familjes me aftësi të kufizuara;
- Nuk ka të dhëna sa i përket numrit të PAK që kanë nevojë apo marrin shërbime për aftësimim për tregun e punës;
- Nuk ka të dhëna se sa është numri i shërbimeve mjekësore që u ofrohen PAK
- Nuk ka të dhëna se sa PAK marrin shërbime shëndetësore në gjuhën e shenjave;

Megjithatë, një objektivë e tërë e Strategjisë i dedikohet krijimit të kushteve të barabarta për qasje, informim, komunikim, dhe sistem të unifikuar të të dhënave. Me implementim të aktiviteteve nën këtë Strategji obligohen MASHT, komunitat, MSH, ZQM dhe një numër i institucioneve tjera.

Qasja fizike në objekte publike

Objektiva e parë specifike e plani të veprimit 2013-2015 “Hulumentimi sipas nevojës në gjendjen në terren lidhur me qasjen në objekte për PAK”, që parasheh hulumentim të gjendjes sa i përket qasjes dhe pastaj organizimit të fushatave vetëdijësuese për të njejtën, përsëritet edhe në planin e ardhshëm të veprimit 2018-2020. Deri tani vetëm në Prishtinë dhe Gjakovë janë të identifikuar objektet të cilat nuk kanë qasje fizike për PAK, dhe kjo është bërë nga HandiKos.²⁰ Përveq këtyre komune, edhe komuna e Drenasit është në proces të hulumentimit. Ndërsa sa ju përket komunave të tjera, nuk ka ndonjë zhvillim në këtë drejtim.

Hulumtime të veçanta për qasje fizike janë paraparë të bëhen në objektet shëndetësore. Konkretisht parashihet një hulumtimi rreth qasjes në institucione shëndetësore për PAK, përkatësisht ndërtimin dhe funksionalizimin e rampave për qasje me pjerrësi maksimale prej 6% dhe të tualeteve në objektet shëndetësore publike sipas standardëve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ 33/2017. Kjo me qëllim të përmirësimit të situatës aktuale. Nga kjo ka dalë se vetëm 24% të objekteve shëndetësore kanë qasje fizike për PAK, por sa i përket tualeteve me nevoja për PAK, kjo nuk dihet.

Në kuadër të iniciativave për sigurim të qasjes, janë paraparë edhe fushata vetëdijësuese për rëndësinë e qasjes së PAK. Sipas MAPL-së janë organizuar fushata vetëdijësuese me zyrtarët komunal për të drejtat e njeriut dhe komunitetin e aftësisë së kufizuar me temat: të drejtat e njeriut për të gjithë; të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; përfshirja e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara në proceset vendimarrëse; hartimi i planeve lokale për persona me aftësi të kufizuara, të drejtat sociale për grupet e marginalizuara; dhe mbrojtja nga diskriminimi; ndër të tjerash. Mirëpo, sa ju përket fushatave vetëdijësuese për qytetarët, nuk ka informacion se është mbajtur ndonjë e tillë.

Edhe në Planin e Veprimit 2018-2020 rëndësi e veçantë i kushtohet qasjes fizike në objekte, mirëpo me fokus në nivelin lokal. Pra për hulumtimin e gjendjes në terren lidhur me qasjen në objekte për PAK, dhe pastaj dy aktivitetet pasuese: (1) Zhvillimi i planeve në nivel lokal për sigurimin e qasjes për PAK për përmirësimin e gjendjes ekzistuese dhe (2) Fushata vetëdijësuese për rëndësinë e qasjes së Personave me Aftësi të Kufizuara, institucioni zbatues kyq janë komunat, me mbështetjen e MMPH dhe MAPL ndër të tjerash. Pasi që fokusi i këtij monitorimi ka qenë i drejtuar kah institucionet qendrore kryesisht, nëpërmjet MAPL-së dhe ZQM-së jemi munduar të kuptojmë se si qëndron situata në terren. Sipas ZQM - përgjegjësia për qasje është e shpërndarë në institucione të ndryshme lokale dhe qendrore. Ndërsa nga informatat e dhëna nga MAPL, planet lokale për persona me aftësi të kufizuara kanë hartuar deri tani vetëm 10 komuna.

Por sa u përket objekteve individuale, nuk dihet se sa objekte publike kanë qasje për PAK. Udhëzimi administrativ 33/2007 për ndërtimet e reja i obligon të gjitha ndërtesat që t'i plotësojnë standardet e vendosura, por MAPL nuk ka të dhëna se sa po zbatohet në praktikë.

Përfundimisht, nuk ka informata të sakta në lidhje me sigurimin e qasjes në objekte shkollore, me qëllim të sigurimit të infrastrukturës së përshtatshme në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sa u përket objekteve shëndetësore, nga informatat e dhëna nga MSH, vetëm 24% e tyre kanë qasje për PAK.¹⁹

[Qasja në informata](#)

19. Intervistë me zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Divizioni për Arsimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, Prill, 2018.

Qasja në teknologji informative dhe komunikuese është një aspekt tjetër tejet i rëndësishëm për një jetë të dinjitetshme dhe kualitative të PAK. Qasja në informacion në kohën kur teknologjia e informacionit është pjesë e jetës së përditshme dhe kërkesë për shumë vende të punës, është më tepër nevojë se sa privilegj. Për këtë, plani i veprimit parasheh krijimin e qasjes në informacion sipas standardit w3c për PAK. Në këtë aspekt, MAPL - ka realizuar projektin INVOLV për qasje në informacion të personave me aftësi të kufizuara.²⁰ Projekti ka qenë i shtrirë dhe është zhvilluar në këto organizata: Shoqata e të Verbërve - katër persona; HandiKos - katër persona, dhe Shoqata e të Shurdhërve - katër persona, me ç'rast janë mbajtur trajnime intenzive për teknologji informative për PAK, janë pajisur të 12 pjesëmarrësit me lloptop dhe Jaus dhe janë publikuar katër libra për teknologjinë informative në alfabetin brail. Por përveq kësaj iniciative prej së cilës kanë përfituar 12 PAK, nuk është bërë ndonjë arritje tjetër për krijim apo lehtësim të qasjes së PAK në informacion sipas standardit w3c.

²⁰ Intervistë me zyrtarë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti Ligjor dhe Departamenti për Monitorim të Komunave

REKOMANDIME

Nga vlerësimi i punës së institucioneve në jetësimin e Strategjisë Nacionale për Personat me Aftësi të Kufizuar, FORUMI ofron rekomandimet si në vijim:

Të përgjithshme:

- Të riformatohet dhe fuqizohet Këshilli Nacional i Personave me Aftësi të Kufizuar, përkatësisht:
 - Të ngritet përfaqësimi politik qeveritar në kuadër të Këshillit;
 - T’i ipet rol vendimarrës në vend të atij rekomandues;
 - Të rishikohet rregullorja e punës së këtij mekanizmi;
 - Të inicohet krijimi i grupeve të veçanta brenda ministrive përgjegjëse për fusha të caktuara të aftësisë së kufizuar për t’i adresuar çështjet që rezultojnë nga takimet e Këshillit
- Në proces të draftimit të planeve të veprimit, të mos parashihen aktivitete të cilat në rrethanat eksistuese (mungesë buxheti, mungesi vullneti politik, mungesë ekspertize, etj.) janë të pa mundura për t’u realizuar;
- Në proces të draftimit të strategjive dhe planeve të veprimit, të respektohet standardi ndërkombëtar i përpilimit të objektivave, që është SMART – pra specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe me afat të parashikuar kohorë;
- Të obligohet niveli lokal për draftim të strategjive lokale për fushën e aftësisë së kufizuar, ku do të specifikohet:
 - Mbledhja e të dhënave se sa PAK jetojnë dhe veprojnë në territorin e tyre;
- Të vlerësohet në mënyrë të rregullt zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve administrative që përmbajnë dispozita për PAK;
- Të krijohet një sistem i unifikuar i mbledhjes së të dhënave për PAK në nivel vendi;

Fusha e Shëndetësisë:

- Te funksionalizohet sa më shpejtë njësi spinale;
- Të krijohet një data bazë e të dhënave që sa persona me aftësi të kufizuar janë duke marrur shërbime shëndetësore, evidencë e gjeneruar e të dhënave, për llojin e aftësisë dhe llojin e shërbimit që ata përfitojnë ata brenda vitit;
- Broshurat apo fletushkat vetëdijësuese për çështje të ndryshme të shëndetit publik si gripet sezonale, rëndësia e vaksinimit të fëmijëve apo këshilla për shëndetin, duhet të jenë prezente nëpër sallat pritëse të qendrave të mjekësisë familjare, sidhe nëpër spitalet regjionale, të pregaditen në shkrimin Brail apo në video në gjuhën e shenjave, kjo në mënyrë që personat e verbër dhe të shurdhër të kenë qasje në këto informata.

Fusha e Punësimit dhe Mirëqenjes Sociale:

- Të krijohet kodi buxhetor për finansimin e shërbimeve sociale në nivel lokal;
- Të nxirren akte nënligjore për Ligjin për Punësim;

- Të penalizohen institucionet publike dhe bizneset që nuk i respektojnë dispozitat ligjore që kërkojnë punësimin e PAK;
- Të krijohen programe të përshtatshme për PAK në kuadër të qendrave për aftësim dhe riaftësim profesional;

Fusha e Arsimit:

- Të ngriten kapacitetet profesionale të mësuesëve të rregulltë për sa i përket qasjes me fëmijet me aftësi të kufizuara;
- Të ngritet numri i mësuesëve mbështetës dhe asistentëve profesional në shkolla;
- Të fuqizohen ekipet për vlerësimin pedagogjik të FNV, përfshirë ngritjen e kapaciteteve profesionale, komenzimin e tyre dhe themelimin e Dhomave Miqësore.
- Të trajnohen stafi në të gjitha nivelet e edukimit (arsimin parafillor, fillor, të mesëm dhe universitar), për gjithëpërfshirje.
- Të krijohen linja të veçanta buxhetore në komuna për arsimin e FNV-ve;

Fusha e Mbrojtjes Ligjore:

- Të aprovohet koncept-dokumenti dhe të hartohet/aprovohet Ligji për Gjithëpërfshirje dhe Trajtim të Barabartë të PAK;

Qasja

- Udhëzimi Administrativ 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e PAK, të shëndërrohet në legjislacion primar për shkak të rëndësisë që ka për fushën e qasjes fizike për PAK;
- Të mbikqyret zbatimi i Udhëzimit Administrativ 33/2007 dhe të përcaktohen masat ndëshkimore për shkelësit;

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Ky grant është financiar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financiar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).